



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVETKOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

KOMISIONI DISIPLINOR//DISCIPLINSKA KOMISIJA/ THE DISCIPLINARY COMMITTEE

KD.nr.02/2018

KOMISIONI DISIPLINOR, në përbërje nga gjyqtarët, Nenad Lazic, kryetar, Manushe Karaqi dhe Skender Çoçaj, anëtarë të Komisionit, në procedurë disiplinor kundër Xxxxxx Xxxxxxx, Gjyqtare në Gjykatën Themelore në xxxxxxx, sipas raportit përfundimtar të Zyrës së Prokurorit Disiplinor me numër ZPD-2017-148, në procedurë të Komisioni Disiplinor ka marrë numrin KGJK/KD/12/2017, për sjellje të pahijshme të përcaktuar sipas nenit 34 paragrafi 1 pika 1.2-neglizhencë në kryerjen e detyrave, dështim për të kryer, apo keqpërdorim i funksioneve gjyqësore, dhe 1.4-shkelje e kodeve të zbatueshme të etikës sipas Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës (Nr.03/L-223), në seancën dëgjimore të mbajtur në prezencën e përfaqësuesit të ZPD-së, xxxxx xxxxxxi, dhe gjyqtares xxxxx xxxxxx, më datën 31.01.2018, në bazë të nenit 37 paragrafi 1 pika 1.3 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës merr këtë:

V E N D I M

1. Xxxxx xxxxx, Gjyqtare në Gjykatën Themelore në xxxxxxx, **është** përgjegjës për sjellje të pahijshme sipas raportit përfundimtar të Zyrës së Prokurorit Disiplinor me numër ZPD-2017-148, i njëjti në procedurë të Komisioni Disiplinor ka marrë numrin KGJK/KD/12/2017, të përcaktuar në nenit 34 paragrafi 1 pika 1.2-neglizhencë në kryerjen e detyrave, dështim për të kryer, apo keqpërdorim i funksioneve gjyqësore, dhe 1.4-shkelje e kodeve të zbatueshme të etikës, sipas Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës (Nr.03/L-223).
2. Për shkak të vërtetimit të sjelljes së pahijshme, gjyqtares xxxxx xxxxx i shqiptohet masa disiplinore Ulje e përkohshme e rrogës për 50% në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, duke filluar prej muajit në vijim pasi vendimi të bëhet i plotfuqishëm.

A r s y e t i m

Zyra e Prokurorit Disiplinor i'a ka paraqitur raportin përfundimtar me numër ZPD-2017-148 se bashku me shkresat e lëndës Komisionit Disiplinor të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, më të cilin gjyqtaren xxxxx xxxxx e ka akuzuar për sjellje të pahijshme të përcaktuara sipas nenit 34 paragrafi 1 pika 1.2-neglizhencë në kryerjen e detyrave, dështim për të kryer, apo keqpërdorim i funksioneve

gjqësore, dhe 1.4-shkelje e kodeve të zbatueshme të etikës sipas Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës (Nr.03/L-223).

Ndaj gjyqtarës xxxxxx Zyra e Prokurorit Disiplinor hetimin disiplinor e ka filluar bazuar nga informacionet e pranuar nga një zyrtar i gjykatës me datë 13 prill 2017, me pretendimet se gjyqtarja Sxxxxx, përkundër faktit që pranon pagën mujore e njëjta nuk e ushtron funksionin e saj gjyqësor, dhe nuk paraqitet në vendin e punës. Gjatë hetimit disiplinor ZPD ka siguruar prova të pa kontestueshme, në mbështetje të këtij raporti përfundimtar, andaj bazuar në nenin 34 paragrafi 1 të Ligjit për KGJK-ën, i rekomandoj Komisionit Disiplinor, inicimin e procedurës disiplinore, sepse gjyqtarja nuk ka arritur ta përfaqësojë gjykatën, duke mos e kryer funksionin e saj gjyqësor. Po ashtu ka dështuar ta kryej funksionin gjyqësor dhe ka bërë shkelje të kodit të etikës, dhe sjelljes profesionale për gjyqtar.

Gjyqtarja xxxxx në seancën dëgjimore të Komisionit Disiplinor të mbajtur me datë 31.01.2018, ka deklaruar se si gjyqtare dhe kryetare e Gjykatës së xxxxx xxxxxx është emëruar me 01.01.2003, e ka hapur për herë të parë këtë Gjykatë dhe në kushte të pamundshme. Ka punuar si gjyqtare për lëndë civile dhe penale dhe se kundër hapjes së kësaj Gjykate kanë qenë të gjithë qytetaret e xxxx xxxxxx. Ka deklaruar se vazhdimisht ka qenë e sulmuar nga persona të panjohur, i është djegur vetura me të cilin ka bartur të gjithë materialin, është hedhur bombë në objektin e Gjykatës. Gjatë gjithë kësaj kohë sipas gjyqtarës ajo ka qenë e kërcënuar bashke me tri vajzat. Kjo situatë kishte ndodhur deri në vitin 2008, kur edhe kjo Gjykatë ishte mbyllur.

Dekretin e fundit gjyqtarja xxxxx e kishte marrë në vitin 2017, me të cilin ishte emëruar gjyqtar për krime të rënda, kur edhe kishte marrë ftesë për tu zhvendosur në Gjykatën e xxxxxxxx, vitin e kaluar, përkatësisht në Gjykatën Themelore në Xxxxxxxx. Ftesën për të filluar punën në Vushtrri e kishte marrë nga xxxx xxxxx, u.d i kryetarit të Gjykatës Themelore në xxxxx. Kishte filluar punën mirëpo nuk ka mundur të ju përballojë kushteve, udhëtimit për çdo ditë Mitrovicë Vushtrri, me vendosjen me një zyrë afër arkivit dhe tualetit i cili ishte i pa rregulluar, nuk kam mundur të i përballojë këtyre kushteve.

E pyetur nga Komisioni se a ka pranuar ndonjë lëndë, gjyqtarja xxxxxx është përgjigjur që jo.

Gjyqtarja ka deklaruar se kishte kërkuar edhe transferim në Prishtinë të ambasadori i Amerikës në Kosovë mirëpo i ishte thënë që shume shpejt do të fillojë punën Gjykata në veri. Momentalisht gjyqtarja Xxxxx është gjyqtare në Gjykatën Themelore në Xxxxxx në departamentin civil, ku ende nuk i janë ndarë lëndë.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i ZPD-së deklaroj se e mbështet në tërësi raportin përfundimtar, ka konsideruar se faktet e prezantuara në këtë seancë janë të pa kontestueshme dhe i ka rekomanduar Komisionit ta shpall përgjegjëse gjyqtaren xxxxxxx për kryerjen e sjelljes se

pahijshme dhe ti shqiptoj një sanksion disiplinor në përputhje me rrethanat dhe nivelin e përgjegjesisë.

Gjyqtarja Xxxxxxx në fjalën përfundimtare ka deklaruar se i falënderon te gjithë për bashkëpunim të ata qe ka punuar për hapjen e Gjykatës, KGJK-ën dhe IGJK-ën ku ka qene trajnerë për gjyqtar dhe prokuror dhe se nuk i ka munguar asnjëherë përkrahja deri ne 2008 me rastin e shpalljes se pavarësisë, ku në veri ka ndodhur ndryshime politike dhe te sigurisë. Asnjëherë nuk ka qene e ftuar nga zyrtare shtetëror qe te ju raportoj për kërcënimet qe i kishte përjetuar gjyqtarja xxxxxxx, kam jetuar me frik duke pritur se do te me bjer bomba ne kokë.

Komisioni Disiplinor i administroj të gjitha provat në shkresat e lëndës, parashtresat e dorëzuara nga ZPD-ja të cilat nuk kanë qenë të bashkangjitura në raportin përfundimtar. Pasi i shqyrtoj dhe analizoj të gjitha provat, analizoj edhe deklaratën e gjyqtares xxxx Xxxxxx konstatoj se ekziston përgjegjësi e rëndë disiplinore e gjyqtares Xxxxxx. Sipas vlerësimit të Komisionit qëndron pretendimi i ZPD-së se znj.Xxxxxx ka bërë shkelje disiplinore me të cilat është ngarkuar, dhe se rrethanat e shumta lehtësuese të cilat i ka cekur dhe ekzistenca e të cilëve është e sigurt, nuk janë të ndërlidhura nga ekzistenca e shkeljes disiplinore.

Në seancën për këshillim dhe votim Komisioni njëzëri vendosi së Xxxxx Xxxxx është përgjegjës për sjellje te pahijshme të një gjyqtari sipas nenit 34 paragrafi 1 pika 1.2-neglizhencë në kryerjen e detyrave, dështim për të kryer, apo keqpërdorim i funksioneve gjyqësore, dhe 1.4-shkelje e kodeve të zbatueshme të etikës. Lidhur me këtë, Komisioni në seancën për këshillim dhe votim, në mënyrë unanime i shqipton masën disiplinore **Ulje e përkohshme e rrogës për 50% në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve**, duke filluar prej muajit të ardhshëm pasi vendimi të bëhet i plotfuqishëm.

Me rastin e e shqiptimit të masës disiplinore, Komisioni, si rrethanë lehtësuese, mori parasysh edhe situatën jashtëzakonisht komplekse në atë pjesë të Kosovës, e cila është dëshmi e mjaftueshme dhe fakti që statusi i institucioneve gjyqësore nuk mund të zgjidhej dhe madje as krijimi i të njëjtëve nuk ishte i mundur pa marrëveshje ndërkombëtare, në krijimin e të cilave ishte pjesëmarrëse aktive bashkësia ndërkombëtare, ku zbatimi i të cilave do të ishte i pamundur pa të. Në këtë situatë në terren, është vërtet joreale të presësh një individ, një gjyqtar, të punojë, të planifikojë gjykimet dhe të bëjë gjykime në periudhën para zbatimit të Marrëveshjes së Brukselit. Thjesht diçka e tillë nuk ishte e mundur.

Nga ana tjetër, është një pikëpyetje e madhe çështja dhe mundësia që ata gjyqtarë të angazhoheshin në gjykata të tjera, pasi që këta gjykatës dhe familjet e tyre janë të ekspozuar ndaj vështirësive, kërcënimeve dhe dënimit të mjedisit nuk duhet të shqetësohen. Vetëm arsyet e cekura të lartpërmendura kanë ndkuar që masa më e rëndë disiplinore e shqiptuar, nga ky Komision, t'i shqiptohen gjyqtares xxx, sepse ne rastin konkret flitet për shkelje e rëndë disiplinore, ekzistenca e së cilës është e pakontestueshme.

Në bazë të nenit 37 paragrafi 1 nën pikën 1.3 dhe paragrafit 2 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR
KD-nr.02/2018, date 31.01.2018

Kryetar i Komisionit Disiplinor
Nenad Lazic

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese pranë Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në Prishtinë, brenda 15- ditësh nga dita e pranimet të Vendimit.

Vendimi u dërgohet:

- Nehat Idrizi, kryesues i KGJK-ës;
- Arianit Salihu, u.d drejtor i Zyrës së Prokurorit Disiplinor;
- Xxxxx xxxxx, kryetare në Gjykatën Themelore në Xxxxxxx;
- Xxxxx xxxxx, Gjyqtare në Gjykatën Themelore në xxxxxxxxx;
- Departamentit të Administratës dhe Personelit në SKGJK;